



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1550/19 Prot.

Tiranë, më 13.06 2023

VENDIM

Nr. 69 dt. 13.06 2023

PËR

**HAPJEN E THIRRJES PËR VETËKANDIDIM PËR ANËTAR TË
KOMISIONIT TË MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT**

Në zbatim të nenit 38 pika 1 (gërma i) të nenit 38, nenit 46 pika 3 dhe 6 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, nenit 20 (gërma nj) si dhe nenit 26 të Statutit të UST-së, nenit 4 të Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Përherëshëm në Nivel Institucioni, të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, nenit 23 të Rregullores për Organizimin e Zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UST, Senati Akademik në mbledhjen e datës 13.06.2023,

V E N D O S I :

- Hapjen e thirrjes për vetëkandidimin për anëtar të Komisionit të Marrëdhënieve me Studentët, me këtë përbërje:
 - 3 (tre) anëtar staf akademik nga një përfaqësues për fakultet;
 - 1 (një) anëtar personel ndihmësakademik me karakter administrativ nga drejtoria që mbulon marrëdhëniet me studentët, alumni, koordinimin dhe komunikimin;
 - 1 anëtar përfaqësues i studentëve;
- Regjistrimi i kandidatëve të kryhet pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UST-së për 7 (shtatë) ditë pune, nga data 14.06.2023 deri në 22.06.2023.
- Kandidatët e interesuar në momentin e aplikimit duhet të cilësojnë qartë emrin e komisionit ku vetëkandidojnë.

4. Sekretari i Senatit Akademik të përpilojë “Njoftim” për të gjithë të interesuarit me të dhënat e sakta për kriteret, mënyrën, vendin dhe periudhën kohore të aplikimit.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi drejtuesit e njësive kryesore si dhe Sekretari i Senatit Akademik.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

